

AKT THEMELIMI DHE STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “WEST PARK RENTAL”

NENI 1 EMRI I SHOQËRISË

1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “WEST PARK RENTAL” sh.p.k., më poshtë e quajtur Shoqëria

NENI 2 SELIA

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Andon Zako Çajupi, 20/4, Tiranë, Shqipëri.

2.2 Asambleja e Shoqërisë mund të vendosë mbi transferimin e selisë në një adresë tjetër. Organi përfaqësues mund të themelojë ose të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3 KOHËZGJATJA

3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.

NENI 4 OBJEKTI I SHOQËRISË

4.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:

- a. Dhënie me qira e automjeteve
- b. Import-eksport të automjeteve
- c. Blerje dhe shitje automjetesh
- d. Transport mallrash
- e. Aktivitet në fushën e hoteleri-turizimit

4.2 Për përmbushjen e objektit të saj Shoqëria:

- a. Mund të marrë pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose të subjekteve pjesëmarrëse;
- b. Mund të lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë, bashkë-investitorë, pronarë trualli apo objektsh, operatorë dhe administrues të strukturave turistike;
- c. Mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme ose të dobishme ose që kanë të përfshirë por pa u kufizuar në: ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për

detyrimet e veta dhe të të tretëve, veprime me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, tregtare dhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose që mundëson një përdorim më të mirë të strukturave dhe/ose burimeve nëpërmjet shoqërive ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt, Shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre.

4.3 Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës me qëllim të përmbushë ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË

5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100.000 (Njëqind mijë) Lekë.

5.2 Ortak i vetëm i Shoqërisë me 1 kuotë nga 1 gjithsej, pra me 100% të kapitalit, është Erind Bako, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë me nr. ID 038070250 dhe nr. personal J50329048H.

5.3 Ortaku mund të shesë një pjesë të kuotës kur dhe nëse e gjykon të arsyeshme.

NENI 6 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

6.1 Shoqëria administrohet nga ortaku i vetëm.

6.2 Ortaku mund të caktojë një administrator tjetër nëse e gjykon të arsyeshme.

6.3 Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të shoqërisë, përveç atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut ia rezervon Ortakut të vetëm të Shoqërisë.

6.4 Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Ortaku. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e Shoqërisë.

6.5 Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti interesi, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakun, si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Ortaku.

NENI 7 KONTROLI FINANCIAR

7.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

NENI 8
VITI FINANCIAR

8.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron në 31 dhjetor të çdo viti.

NENI 9
BILANCI VJETOR

9.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 10
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

10.1 Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

NENI 11
LIGJI I ZBATUESHËM

11.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

NENI 12
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

12.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve ta tjerë dhe/ose Shoqërisë, që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen miqësisht ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Ortaku i Vetëm
Erind Bako


Erind Bako

Tiranë, 20.06.2022.